



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. 3993 Prot.,
14

Tiranë, më 31.8.2021

URDHËR

Nr. 551, datë 31.8.2021

**“PËR MOS LICENCIMIN E SHOQATËS “TRANSMETUESE RADIOTELEVIZIVE
KABLLOR VALOR (RrTL)” NË ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE
NË FUSHËN E PRODHUESVE DHE AUTORËVE TË AUDIOVIZUALITETIT,
ORGANIZATAT TRANSMETUESE “OSHMA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 134, 135, 157 dhe 158 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, kërkesës shoqatës “Transmetuese radiotelevizive kabllor valor (RrTL)” nr. 3704 prot., datë 16.07.2021, si dhe legjislacionit në fuqi “Për organizatat jo-fitimprurëse”:

U R D H Ë R O J:

1. Mos licencimin e shoqatës “Transmetuese radiotelevizive kabllor valor (RrTL)” në fushën e prodhuesve dhe autorëve të audiovizualitetit, organizatat transmetuese “OSHMA”.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
3. Kundër këtij urdhri, kërkuar ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
ELVA MARGARITI

